

26 - 04 - 2018

P.nr.2560/2017

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, me sekretaren juridike Arditra Imeri, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDAKTUE], nga fshati [REDAKTUE], Komuna Ferizaj, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1299-2/16 të dt.12.10.2017, sipas së cilës ë ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.I të KPRK-së duke vendosur rreth kërkësës për dhëni e urdhërit ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.15.12.2017 solli:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1299-2/16 e datës 12.10.2017 dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDAKTUE], nga fshati [REDAKTUE] Komuna Ferizaj, lindur me datë, [REDAKTUE], në të njëtin vend, nga i ati [REDAKTUE] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personale [REDAKTUE] mbrohet në liri,

ËSHTË FAJTOR

Sepse - me dt. 01.08.2016, rreth orës 19:50, në rrugën lokale në fshatin Cërnillë Komuna Ferizaj, duke drejtuar automjetin, e markës " Audi 89 ", me targa të regjistrimit [REDAKTUE], duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 42/1 të LSKRR-së, nga pakujdesia, ndërmerr veprimin e kyqjes nga rruga dytësore në rrugën kryesore pa u bindur se një veprim të tillë mund ta bëjë pa i rrezikuar pjesëmarrësit tjerë të cilët kanë përparësi kalimi, dhe me pjesën e përparme të anës së djathtë e godet në pjesën e pasme të djathtë automjetin e markës " Shkoda Oktava ", me targë të regjistrimit [REDAKTUE], ë cilin e drejtonte [REDAKTUE], e cila nga forca e inercionit bartet dhe kalon në shiritin e kahjes së kundërt ku përplaset në pjesën e përparme të majtë me automjetin e markës " Mercedes ", me tarë të regjistrimit [REDAKTUE], të cilën e drejtonte [REDAKTUE] nga fshati [REDAKTUE] komuna Ferizaj, me të cilin rast pos dëmeve materiale, lëndime të lehta trupore pëson pasagjerja [REDAKTUE] lëndime këto të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 17.09.2017,-.

- me të cilën kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.I të KPRK-së

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPK-së dhe neneve 365 q 495 të KPPK-së i shqipton

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit [REDAKTUE], i shqiptoi dënimin me gjobë në shumën prej 200 € (dyqind €uro), të cilën shumë i akuzuarit obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nëse dënimini me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjtë do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 €uro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

Gjykata të dëmtuarit: [REDACTED] dhe [REDACTED] që të dy nga [REDACTED], [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale 60.88€ dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1299-2/16 të dt 12.10.2017, ka akuzuar [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna Ferizaj, për veprën penale rezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe në aktakuzë ka parashtruar kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimore kundër të akuzuarit me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i njëjtë.

Gjykata gjatë shqyrimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimore, në vështrim të nenit 495 parag.1, 2 dhe 3 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimore.

Nga provat materiale të bashkëngjitura në shkresat e lëndës gjegjësisht konstatimin e ekspertit mjeko ligjor i dt.17.09.2017, mendimi i ekspertit të komunikacionit i datës 05.09.2017, deklarata e të pandehurit e dt.01.10.2016, deklaratat e të dëmtuarit e dt.01.08.2016, si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka konstatuar se këto prova janë të bazuara dhe bindëse, sepse vërtetojnë që i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par.3 të KPPK-së të dëmtuarit: [REDACTED] dhe [REDACTED] që të dy nga [REDACTED], [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Konformë nenit 450 dhe 451 të KPPK-së obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 60,88 Euro, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr.2560/2017 i dt.15.12.2017

Sekretarja juridike
Ardita Imeri



UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së njëjtë, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimore bëhet i plotfuqishëm dhe ekzekutohet dënim i shqiptuar.